



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 6290 Prot.

Ballsh, më 20 . 12 .2022

VENDIM

Nr. 73 Datë 19 / 12 / 2022

**PËR MIRATIMIN E DRAFT AKT MARRËVESHJES NDËRMJET BASHKISË
MALLAKASTËR DHE POSTËS SHQIPTARE**

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar, ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.869, datë 18.06.2008 “Për zbatim të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar”, VKM-së nr.31, datë 20.01.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, e i ndryshuar, VKM-së nr.78, datë 07.02.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të paketës të vecantë higjeno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar, si dhe të VKM-së nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, VKB nr. 12, datë 24.02.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak”

VENDOSI

- I. Miratimin e draft akt-marrëveshjes ndërmjet Bashkisë Mallakastër dhe Postës Shqiptare për kryerjen e shërbimit të pagesave të përfitimit të paaftësisë për invalidin, të aftësisë së kufizuar, përfitimit të ndihmës ekonomike dhe pagesa shtesë për paketën të vecantë higjeno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë nga Filiali i “Posta”
- II. Vlera e pagesës për kryerjen e shërbimit nga Posta Shqiptare do të përballohet nga Buxheti i Bashkisë Mallakastër (të ardhurat) për vitin 2023.
- III. Ky vendim shoqërohet me draft akt-marrëveshjen.

KRYETAR

Fitim Baraj

